



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

V E N D I M

Nr. 20, datë 10.07.2025

PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KANDIDATURËS SË ZOTIT LULZIM HAMITAJ NË VENDIN VAKANT, PËR GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, SHPALLUR NGA GJYKATA E LARTË MË DATË 11.12.2024

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga:

Sokol Sadushi	Kryetar
Marjana Semini	Zëvendëskryetare
Ilir Toska	Anëtar
Alma Muça	Anëtare
Elvana Cicolli	Anëtare zëvendësues
Enkela Vlora	Anëtare relatore
Etien Kapo	Anëtar
Genti Xholi	Anëtar zëvendësues
Nafije Hasko	Anëtare

Asistuar nga sekretare Fabjola Muhameti, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuar sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve: 1. Mary Kate Butterfield, këshilltare ligjore rezidente pranë OPDAT dhe përkthyesja Sarmela Titka, 2. z.Genti Çani, përfaqësues i Avokatit të Popullit me autorizim nr.221 prot., datë 27.03.2025, në mbledhjen e datës 10.07.2025, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

KANDIDATIT: **Lulzim Hamitaj**

OBJEKTI: Kandidim për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese në vendin vakant të shpallur nga Gjykata e Lartë më datë 11.12.2024.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoi relatimin e anëtares së KED, zonjës Enkela Bajo, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20,
Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al, Numra telefonikë : +355 4 2257302**

1. Në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/ç të Ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, më datë 11.12.2024, Gjykata e Lartë ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant, të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, pas deklarimit të mbarimit të mandatit të gjyqtarës Holta Zaçaj.

2. Në përfundim të afatit të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Gjykata e Lartë i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, listën e kandidatëve që kanë shprehur interes për këtë vend vakant në Gjykatën Kushtetuese, në të cilën përfshihej dhe kandidati Lulzim Hamitaj, së bashku me dokumentacionin e paraqitur prej tyre, për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore, të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

3. Në datë 15.01.2025, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED), realizoi procedurën e shortit për përzgjedhjen e anëtarit relator dhe të këshilltarit ligjor për këtë vakancë, sipas nenit 228 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, pikës 4 të vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar (në vijim vendimi nr. 4/2019 i KED) dhe vendimit të KED-së nr. 2 datë 15.02.2019 “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”, i ndryshuar. Me anë të kësaj procedure, relatore për këtë vakancë u përzgjodh anëtarja Enkela Vlora, ndërsa këshilltare ligjore Bjorka Duka.

4. Në datë 17.01.2025, kandidati Lulzim Hamitaj u njoftua me shkrim, në rrugë elektronike për t’u paraqitur brenda tre ditëve në zyrën e posaçme të KED-së për tërheqjen e formularëve standard dhe të udhëzimeve të nevojshme për vijimin e procedurës së verifikimit të kandidimit të tij. Ky njoftim u krye në zbatim të pikës 22 të vendimit nr. 4/2019 të KED-së, në adresën e postës elektronike të deklaruar nga vetë kandidati Lulzim Hamitaj dhe kopje e email-it është administruar në dosjen e kandidimit. Gjithashtu në zbatim të detyrimeve ligjore të parashikuara në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar; si dhe Vendimin nr.4, datë 11.3.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, kandidatin Lulzim Hamitaj i është njoftuar dhe emri i relatores dhe këshilltarit të caktuar.

5. Në datën 20.01.2025, kandidati Lulzim Hamitaj në rrugë elektronike, konfirmoi marrjen e njoftimit dhe deklaroi se nuk ka dijeni për shkaqe papajtueshmërie si me relatoren dhe këshilltaren. Gjithashtu në lidhje me konfliktin e mundshëm të interesit, në raport me anëtarë e Këshillit, rezervoi të drejtën për tu shprehur në një moment të dytë.

6. Në datë 21.01.2025, kandidati Lulzim Hamitaj, u paraqit pranë KED-së dhe tërhoqi për plotësim formularët standard të deklarimit dhe autorizimet e duhura për procedurën e aplikimit për plotësimin e vendit vakant, objekt i kësaj procedure verifikimi, midis të cilave edhe ato për deklarimin e pasurisë dhe interesave financiare.

7. Në datë 24.01.2025, kandidati është paraqitur pranë KED për dorëzimin e autorizimeve dhe deklarimeve përkatëse. Për këtë arsye, është mbajtur edhe proces-verbali me nr. 48 Prot., datë 24.02.2025 sipas të cilit janë pasqyruar në mënyrë të detajuar: Autorizim, lëshuar nga kandidati, për Verifikimin e Pasurisë, Interesave Private dhe Detyrimeve Financiare, për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi; Autorizime, lëshuar nga personat e lidhur, për Verifikimin e Pasurisë, Interesave Private dhe Detyrimeve Financiare, për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi; Autorizim, lëshuar nga kandidati, për Verifikimin e Figurës dhe Integritetit, për Këshillin e Emërimeve në

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

**Adresa Postare : *GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20,
Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.***

Adresa Elektronike : *info@ked.gov.al*, Numra telefonikë : +355 4 2257302

Drejtësi; Autorizim për Verifikimin e Kushteve dhe Krieteve të Tjera Ligjore për gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese dhe për Vlerësimin e Kandidaturës, për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi; Deklaratë për Dhënien e Pëlqimit për Mbledhjen dhe Përpunimin e të Dhënave Personale", lëshuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi; Deklaratë për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktet telefonike të kandidatit; Formular vetdeklarimi për pozicionet drejtuese të mbajtura në parti politike nga kandidati për anëtar i Gjykatës Kushtetuese; Deklaratë për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktet telefonike të KED.

8. Përgjatë kësaj periudhe Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka zhvilluar korrespondencë të plotë me organet ligjzbatuese, ILDKPKI dhe institucionet ku kandidati ka qënë i punësuar si dhe me kandidatin për të kryer verifikimin e krieteve të pasurisë, integritetit dhe krieteve dhe kushteve të tjera ligjore.

9. Në datën 12.06. 2025, kandidati përcolli përpara Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, kërkesën për përjashtimin e dy anëtarëve të Këshillit, përkatësisht znj. Balli dhe z. Vjerdha.

10. Me vendimin Nr. 1 datë, datë 17.06.2025, Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi vendosi mbi pranimin e kërkesës për përjashtim të anëtarit z. Fuat Vjerdha nga procesi i verifikimit dhe i pikëzimit të kandidatit Lulzim Hamitaj në kandidimin për vendin vakant të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, shpallur nga Gjykata e Lartë me datë 11.12.2024". Me vendimin Nr. 2 datë, datë 17.06.2025, Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi vendosi mbi pranimin e kërkesës për përjashtim të anëtares znj. Irma Balli nga procesi i verifikimit dhe i pikëzimit të kandidatit Lulzim Hamitaj në kandidimin për vendin vakant të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, shpallur nga Gjykata e Lartë me datë 11.12.2024".

11. Në datën 04.07.2025, kandidati është njoftuar mbi rendin e ditës së mbledhjes së datës 10.07.2025, dhe është njoftuar për mundësinë e përcjelljes së komenteve përfundimtare, të cilat i përcolli në anë të emailit me datë 07.07.2025.

12. Në datë 10.07.2025, në orën 13:13 kandidati Lulzim Hamitaj, në rrugë elektronike, në adresën e caktuar për efekt komunikimi (relatorked@gmail.com dhe keshilltarked4@gmail.com), deklaroi se tërhiqet nga aplikimi për pozicionin pranë Gjykatës Kushtetuese. Në thelb kandidati ka parashtruar si vijon:

"Nisur nga nje sere konstatimesh ne relacionin e nisur nga KED, si gjetje te pabazuara dhe/ose te renduara [mes tyre mjafton te permendet, se pari, perllogaritja e gabuar e shumave te paguara per apartamentin ne Vlore (sikurse e kam kundeshtuar, sqaruar dhe provuar me shpjegimet/prapsimet e mia te dates 7.7) dhe, se dyti, konsiderimin si pamundesi te nje shume shtese prej 10.000 euro per automjetin Jeep (ndonese kjo vlere nuk ishte paguar ndonjehere e as nuk mungonin burimet edhe nese ajo do te ishte paguar) si dhe duke konstatuar edhe problematika procedurale si : (i) mos ripercjellja e dosjes time ne ILDKPKI - sikurse eshte vepruar edhe ne raste te tjera nga ana e KED-se - ne vijim te shume provave te reja qe une kam sjelle pas njoftimit te raportit te ILDKPKI-se si dhe me pas te relacionit te KED-se - duke vetatribuuar kesisoj funksionet e ketij organi (ILDKPKI), te strukturuar dhe te specializuar per kryerjen e perllogaritjeve dhe vleresimin e provave ne raport me pasurine, [dhe per pasoje KED arrin te me kerkoje prova mbi emrin tim ne ceqe bankare te patransferueshem (qe nuk mund te kishte...! - sikurse e kam shpjeguar) e duke mos e bere dallimin nga ceqet e zakonshem etj.] dhe (ii) lidhur me mospatjen e nje pergjigje nga KED ne raport me kerkesat e mia procedurale te paraqitura qysh prej dates 7.7.2025, - mbetem i zhgenjyer nga sa me siper dhe per rrjedhoje mosbesues ne nje vlersim objektiv dhe te thelluar e me profesionalizem ekspertize e ne detaje te dosjes time, nga

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

**Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20,
Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al, Numra telefonikë : +355 4 2257302

specialiste te fushes dhe/ose nga eksperte qe vet KED mund te kishte emeruar - bashkengjitur ketij emaili po ju paraqes kerkesen per t'u terhequr nga kandidatura ime.

13. Bashkëlidhur emailit, kandidati ka paraqitur, një deklaratë të nënshkruar ku deklaron terheqjen nga kandidimi si më poshtë:

“Të nderuar anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Pasi mora dijeni për disa rrethana të reja në rrafshin profesional dhe familjar, vlerësoj të paraqes, sikurse nëpërmjet kësaj kërke po paraqes, tërheqjen nga kandidatura ime për Gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese dhe rrjedhimisht nga procedura e vlerësimit që është në vijim, pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Duke ju uruar punë të mbarë dhe falënderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin!”

14. Kryetari i KED-së, në bazë të pikës 33 të vendimit nr. 4/2019 të KED-së, në mbledhjen e thirrur dhe të planifikuar më datë 10.07.2025, njoftoi anëtarët për kërkesën e kandidatit dhe rendin e ditës. Në rendin e ditës së datës 10.07.2025 ka qënë e përfshirë edhe çështja me objekt verifikimin e kandidimit të z. Lulzim Hamitaj, për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 11.12.2024. Pas njoftimit të kandidatit, u trajtua kërkesa e tij për heqje dore.

15. Gjithashtu, pas komunikimit me kryetarin e KED-së dhe njoftimit të anëtarëve për kërkesën e re të kandidatit, Lulzim Hamitaj, këtij të fundit i është njoftuar në rrugë elektronike (e-maili i datës 10.07.2025, ora 14:03) koha e zhvillimit të mbledhjes, dhe pranimi i shqyrtimit të kërkesës së tij. Një kopje të njoftimit është administruar në dosjen e kandidatit.

16. Në mbledhjen e Këshillit, u relatua çështja nga anëtari relator dhe u shpjeguan pyetjet sqaruese të drejtuara nga anëtarët e tjerë të KED-së.

II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

17. KED-ja, duke pasur parasysh dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të sipërcituara, bazuar në relacionin dhe aktet e dërguara nga relatori i caktuar për ndjekjen e procedurave për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 11.12.2024, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për përfundimin e procedurës së verifikimit, të kandidatit Lulzim Hamitaj.

18. Në zbatim të neneve 125 dhe 149/d të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 1 të nenit 7/c të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar (referuar në vijim si ligji nr. 8577/2000), Gjykata e Lartë në datën 11.12.2024, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant, të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, për shkak të mbarimit të mandatit të gjyqtarës Holta Zaçaj.

19. Në zbatim të nenit 7/c të ligjit nr. 8577/2000 dhe të nenit 234 e vijues të ligjit nr. 115/2016, pas dërgimit të listës së kandidatëve që kanë shprehur interes së bashku me dokumentacionin e

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20,
Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al, Numra telefonikë : +355 4 2257302**

paraqitur, për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur të shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 11.12.2024, KED ka filluar procedurën e verifikimit të kandidaturave për plotësimin e kushteve dhe kriterëve të kandidimit që parashikohen nga Kushtetuta dhe ligji.

20. Ligji nr. 8577/2000 dhe ligji nr. 115/2016 nuk parashikojnë në mënyrë të shprehur rastin e tërheqjes nga kandidimi dhe mënyrën e disponimit të KED-së në raste të tilla. Nga ana tjetër, ligji nr. 115/2016, në pikën 2 të nenit 229, parashikon se:

“2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, për të siguruar zhvillimin e një procedure transparente, publike dhe bazuar në merita, me vendim, miraton rregulla më të detajuara për përzgjedhjen dhe pikëzimin e kandidatëve, duke përfshirë edhe rregullat për procedurën e verifikimit të pasurisë, integritetit dhe të së shkuarës profesionale dhe personale të tyre”.

21. Mbi bazën e këtij autorizimi ligjor, KED ka nxjerrë vendimin nr. 4, datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, i ndryshuar. Në pikat në pikat 8 dhe 31 të këtij vendimi parashikohet se:

“8. Kandidati ka të drejtë të tërhiqet në çdo kohë nga kandidimi, duke e njoftuar me shkrim Këshillin. Pas këtij njoftimi, Këshilli vendos menjëherë përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatit. Akti i Këshillit për konstatimin e tërheqjes nga kandidimi i njoftohet menjëherë kandidatit dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi”.

[...]

“31. Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projekt-aktin mbi përfundimin e procedurës administrative të verifikimit të kandidatit të tërhequr, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit”.

22. KED-ja, në zbatim të dispozitave ligjore dhe nënligjore, të zbatueshme në rastin e tërheqjes nga kandidimi, vlerëson të rregullt procedurën e ndjekur deri tani për verifikimin e kandidaturës së kandidatit Lulzim Hamitaj. Kandidati është njoftuar rregullisht për fillimin e kësaj procedure, sipas rrugës elektronike në datë 10.07.2025.

23. KED-ja vlerëson se, shprehja e interesit dhe kandidimit për plotësimin e vendeve vakante që krijohen në Gjykatën Kushtetuese është një e drejtë, e cila ushtrohet nga kandidatët ekskluzivisht mbi vullnetin individual të tyre, duke respektuar procedurat, kushtet dhe kriteret e kandidimit që parashikon Kushtetuta dhe ligji.

24. Në rast se personi që kandidon, në çdo kohë e gjendje të procedimit, shpreh vullnetin për të mos vijuar më tej me kandidimin për plotësimin e vendit vakant që krijohet në Gjykatën Kushtetuese, atëherë nuk ka më vend të vijnë procedurat e verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturës, të parashikuara nga ligji dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë e për zbatim të tyre.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

**Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20,
Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al, Numra telefonikë : +355 4 2257302

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të 7/c të ligjit nr. 8577/2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të pikës 3 të nenit 229 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si edhe pikave 8, 31, 34 të vendimit të KED-së nr. 4, datë 11.03.2019, “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,

V E N D O S I:

1. Përfundimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit, së kandidaturës të kandidatit Lulzim Hamitaj, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 11.12.2024, për shkak të tërheqjes së kandidatit nga kandidimi.
2. Në zbatim të nenit 238 të ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatit Lulzim Hamitaj.
3. Kandidati Lulzim Hamitaj ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

ANËTAR

Zv/KRYETARE

KRYETAR

Ilir TOSKA

Marjana SEMINI

Sokol SADUSHI

ANËTARE

**ANËTARE
ZËVËNDESUERE**

ANËTARE

Enkela VLORA

Elvana ÇIÇOLLI

Alma MUÇA

**ANËTAR
ZËVËNDESUERE**

ANËTAR

ANËTARE

Genti XHOLI

Etien KAPO

Nafije HASKO

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20,
Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al, Numra telefonikë : +355 4 2257302**